

**PËRMBLEDHJE**

# Kosovë

**Megjithëse rritja ekonomike u ngadalësua në vitin 2025, ekonomia tregoi qëndrueshmëri mes pasigurive të shtuara.**

**Perspektiva i nënshtrohet rrezikut në kahun rënës, duke përfshirë pasigurinë që rrjedh nga ndikimi i konfliktit në Lindjen e Mesme.**

**Menaxhimi i kujdesshëm fiskal është çelësi për të mbajtur rezerva të qëndrueshme fiskale dhe për t'u dhënë përparësi shpenzimeve që përshpejtojnë rritjen ekonomike.**

Pas një periudhe 3-vjeçare me rritje mesatare mbi 4 për qind, ekonomia e Kosovës u ngadalësua në 3.6 për qind në vitin 2025, pasi konsumi privat u zbut dhe importet u rritën, ndërsa investimi u forcua gradualisht. Pagat dhe transferet e larta, së bashku me rritjen e konsiderueshme të kredive, mbështetën konsumin privat dhe uljen e varfërisë. Eksporti i mallrave mbeti i dobët në një kohë të kërkesës së jashtme të ulët, ndërsa rritja e eksportit të shërbimeve, dominuar nga udhëtimi, teknologjia e informacionit dhe komunikimit, dhe shërbimet e tjera të biznesit, kompensoi në një masë ndikimin e rritjes së importit. Rritja e çmimeve të energjisë dhe ushqimit kontribuoi në rritjen e inflacionit në vitin 2025, gjë që pritet të vazhdojë në vitin 2026 pasi zhvillimet e fundit globale dobësojnë perspektivën.

Mbajtja e rezervave të qëndrueshme fiskale dhe prioritizimi i shpenzimeve që nxisin rritjen ekonomike me qëllim të rritjes së produktivitetit dhe forcimit të konkurrueshmërisë janë të një rëndësie të madhe për Kosovën në një kohë të pasigurisë së shtuar. Rritja e pjesëmarrjes së të rinjve dhe grave në tregun e punës mund të nxisë një rritje ekonomike më të fortë dhe më të qëndrueshme.


**Carole Megevand**  
Menaxhere e Bankës Botërore për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut

Perspektiva afatmesme për rritjen pritet të jetë e përmbajtur në vitin 2026 për shkak të një kombinimi të faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm dhe mbetet e ekspozuar ndaj rreziqeve në kahun rënës. Rritja e çmimeve të energjisë dhe ushqimit pas konfliktit në Lindjen e Mesme pritet të përkeqësojë sektorin e kërkesës së jashtme që tashmë është i vështirë, ndërsa deficit i llogarisë rrjedhëse pritet të qëndrojë mbi 9 për qind mesatarisht.




## Rritja reale e BPV-së

Përqindja




## Përbërja e rritjes vjetore

Pikë përqindjeje



Burimi: Agjencitë kombëtare të statistikave dhe vlerësimet e staft të Bankës Botërore.

Vërejtje: WB6 = Gjashtëshja e Ballkanit Perëndimor; e = vlerësim.



**Për më shumë informacion dhe botimet e mëparshme të Raportit të Rregullt Ekonomik të Ballkanit Perëndimor, klikoni [këtu](#).**